



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS
Komora Farmaceuta Kosova
Kosova Chamber of Pharmacists



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 38 Dt. 08.08.2019

RREGULLORE PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E ANËTARËSIMIT NË OFK

Prishtinë, 2019

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1, në lidhje me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, nenit 20, paragrafin 1, në lidhje me nenin 15, paragrafi 2 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29/06/2019, nxjerrë këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E ANËTARËSIMIT NË OFK

KREU I - DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet procedura e aplikimit, kriteret për regjistrim në Odën e Farmacistëve të Kosovës, mënyra e revokimit të anëtarësisë si dhe përmbajtja e regjistrit të anëtarësisë.

Neni 2 Obligimi i anëtarësisë

Farmacistët të cilët ushtrojnë ose dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në territorin e Republikës së Kosovës, janë të obliguar që të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odën e Farmacistëve të Kosovës

Neni 3 Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

Anëtarësim – procedura e regjistrimit të farmacistit në regjistrin e anëtarëve të OFK-së

Regjistri i anëtarëve – nënkupton regjistrin e OFK-së i cili përmban të dhënat e të gjithë anëtarëve të regjistruar në OFK

Kartela e identifikimit të anëtarit – ID/Certifikatë e cila dëshmon anëtarësimin në OFK

KREU II – KRITERET DHE DOKUMENTET PËR ANËTARËSIM TË FARMACISTËVE

Neni 4

Kriteret për anëtarësim të shtetasve të Kosovës

1. Kriteret për anëtarësim në OFK janë:
 - 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të ketë dhënë provimin profesional të licencës apo të ketë licencë;
 - 1.3. Të jetë i diplomuar si farmacist në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë në vend apo kur ka diplomuar jashtë vendit të ketë të nostrifikuar diplomën në Ministrinë e Arsimit;
 - 1.4. Të ketë paguar taksën administrative për anëtarësim.

Neni 5

Dokumentacioni për dorëzim

1. Farmacisti i cili aplikon për anëtarësim në OFK, duhet të dorëzojë këto dokumente:
 - 1.1. Aplikacionin,
 - 1.2. Kopjen e letërnjoftimit,
 - 1.3. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimit (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHT,
 - 1.4. Kopja e noterizuar e licencës ose certifikata e provimit të licencës,
 - 1.5. Dy fotografi (deri në krijimin e sistemit elektronik),
 - 1.6. Pagesa e taksës administrative të anëtarësisë.

KREU III – KRITERET DHE DOKUMENTET PËR ANËTARËSIM TË FARMACISTËVE TË CILËT NUK JANË SHTETAS TË KOSOVËS

Neni 6

Kriteret për anëtarësim të farmacistëve që nuk kanë shtetësi të Kosovës

1. Për farmacistët të cilët nuk kanë shtetësi të Kosovës aplikohen këto kritere për anëtarësim:
 - 1.1. Të jetë i pajisur me leje qëndrim në Kosovë,
 - 1.2. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimin (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHT,

- 1.3. Të ketë kopje të noterizuar të licencës së punës të lëshuar nga shteti origjinës e përkthyer nga përkthyesi zyrtar në Gjuhën Shqipe, ose të jetë i pajisur me leje pune nga organi kompetent nëse posedohet,
- 1.4. Të ketë paguar taksën administrative për anëtarësim.

Neni 7

Dokumentet e nevojshme për anëtarësim të farmacistëve që nuk kanë shtetësi të Kosovës

1. Për farmacistët të cilët nuk kanë shtetësi të Kosovës që aplikojnë për anëtarësim në OFK, duhet të dorëzojnë këto dokumente:
 - 1.1. Aplikacionin,
 - 1.2. Kopja e noterizuar e lejes së qëndrimit në Kosovë,
 - 1.3. Kopja e noterizuar e licencës së punës nga shteti, shtetas i të cilit është ose kopja e noterizuar e lejes së punës për ushtrimin e profesionit të farmacistit në Kosovë nga MSH nëse posedohet,
 - 1.4. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimin (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHT,
 - 1.5. Pagesa e taksës administrative për anëtarësim.

KREU IV – PROCEDURA E APLIKIMIT PËR ANËTARËSIM

Neni 8

Fillimi i procedurës

1. Farmacisti inicion procedurën e anëtarësimit përmes parashtrimit të aplikacionit dhe dokumentacionit Shërbimit Profesional të OFK-së.
2. Shërbimi Profesional një kopje të aplikacionit të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i OFK-së i dorëzon aplikuesit ose konfirmimi online.
3. Shërbimi Profesional i OFK-së aplikacionin për licencim së bashku me dokumentacion i procedon te Komision për Licencim.

KREU V – PËRMBAJTJA E APLIKACIONIT

Neni 9

1. Aplikacioni për anëtarësimin përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë plotësohet nga aplikuesi dhe përmban të dhënat personale të tij:
 - 1.1. Emri dhe mbiemri;
 - 1.2. Nr. licencës;
 - 1.3. Vendi dhe data e lindjes;
 - 1.4. Adresa e vendbanimit;
 - 1.5. Institucioni në të cilin ka diplomuar, data e diplomimit dhe nr. diplomës;
 - 1.6. Lloji i specializimit dhe data e specializimit (vetëm për specialistët)
 - 1.7. Numri i telefonit;
 - 1.8. Adresa valide e e-mail;
 - 1.9. Nënshkrimi;
 - 1.10. Deklaratën se me nënshkrimin e aplikuesit e gjithë përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e tij.
2. Pjesa e dytë përmban të dhënat mbi dokumentacionin e dorëzuar në OFK dhe nënshkrimin e zyrtarit të OFK-së i cili ka pranuar aplikacionin. Kjo pjesë plotësohet nga zyrtari i OFK-së. Në sistemin elektronik, bëhet validimi elektronik.

KREU VI - SHQYRTIMI, VENDIMET E KOMISIONIT DHE E DREJTA NË ANKESË

Neni 10

Afati kohor i shqyrtimit të kërkesës

Komisioni për Licencim jo më vonë se 15 ditë nga pranimi i kërkesës për anëtarësim është i obliguar të shqyrtojë atë dhe të vendosë në lidhje me të.

Neni 11

Vendimi për miratimin e kërkesës

1. Komisioni për Licencim e miraton kërkesën në rast se janë të plotësuara kushtet e parapara me këtë rregullore.
2. Shërbimi Profesional në bazë të vendimit të Komisionit, e regjistron farmacistin në regjistrin e anëtarëve të OFK-së.

Neni 12
Vendimi për refuzimin e kërkesës

1. Në rastet kur aplikacioni përmban mangësi në plotësimin e dokumentacionit, Komisioni mund të caktojë afat shtesë jo më shumë se 7 ditë nga shqyrtimi i aplikacionit për plotësimin e lëndës.
2. Nëse brenda këtij afati aplikuesi nuk vepron sipas kërkesës së Komisionit, kërkesa e tij refuzohet me vendim.
3. Komisioni refuzon kërkesën me vendim edhe në rastet kur ndaj aplikuesit në kohën në të cilën ka aplikuar i është shqiptuar masa disiplinore e fshirjes nga regjistri i anëtarëve të Odës.

Neni 13
E drejta në ankesë

1. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit për refuzimin e kërkesës për anëtarësi dhe rianëtarësim, ka të drejtë ankesë në afat prej 8 ditësh nga marrja e vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues të OFK-së.
3. Nëse Këshilli Drejtues e vendos se ankesa e tillë është e bazuar, merr vendim për anëtarësimin e ankuesit, duke obliguar Komisionin për Licencim ta regjistrojë në regjistrin e anëtarëve të OFK-së.

Neni 14
Kartela e Identifikimit të anëtarit të OFK-së

1. Nëse Komisioni për Licencim miraton kërkesën për anëtarësim në OFK, të anëtarësuarit i lëshohet kartela identifikuese e anëtarësisë e cila përmban së paku këto të dhëna:
 - 1.1. Emri dhe mbiemri;
 - 1.2. Nr. personal;
 - 1.3. Numri rendor i anëtarësisë.
2. Kartela e anëtarësisë është pronë e odës dhe si e tillë duhet t'iu dorëzohet organeve kompetente të odës me rastin e skadimit të saj apo në rast të çregjistrimit nga regjistri i anëtarëve.
3. Në rast të humbjes së kartelës, anëtari i OFK-së njofton me shkrim Komisionin për humbje duke e arsyetuar atë.

4. Komisioni lëshon kartelën e re, pas kërkesës së anëtarit dhe pagesës së taksës administrative sipas vendimit të Kuvendit.
5. Të dhënat e tjera dhe forma e kartelës vendosen me vendim të Këshillit Drejtues.

KREU VII – REGJISTRI I ANËTARËVE TË ODËS

Neni 15 Regjistrat e anëtarëve

1. Komisioni për Licencim mban dy lloje të regjistrave të anëtarëve:
 - 1.1. Regjistri i anëtarëve të OFK-së shtetas të Kosovës,
 - 1.2. Regjistri i anëtarëve të OFK-së të cilët nuk janë shtetas të Kosovës.

Neni 16 Përmbajtja e regjistrit

1. Kur Komisioni për Licencim merr vendim për regjistrimin e farmacistit në regjistrin e anëtarëve të OFK-së, Shërbimi Profesional i Komisionit regjistron menjëherë të dhënat e farmacistit në regjistër.
2. Regjistri i anëtarëve përmban këto të dhëna:
 - 2.1. Nr. rendor;
 - 2.2. Emrin dhe mbiemrin;
 - 2.3. Nr. e licencës (nëse e posedon);
 - 2.4. Datën e regjistrimit.

KREU VIII - FSHIRJA NGA REGJISTRI I ANËTARËSISË

Neni 17

Fshirja nga regjistri i anëtarësisë

1. Komisioni për Licencim merr vendim për fshirjen e farmacistit nga regjistri i anëtarësisë në këto raste:
 - 1.1. Me revokimin e përhershëm të licencës nga Këshilli Etik, ose vendimit nga Gjyqi i Nderit në rast të ankesës;
 - 1.2. Me kërkesën e anëtarit të Odës;
 - 1.3. Në rast të mospagesës së anëtarësisë për më shumë se gjashtë muaj pas afatit për pagesë;
 - 1.4. Në rast të vdekjes së anëtarit;
 - 1.5. Me ekzekutimin e masës disiplinore të fshirjes nga regjistri i anëtarëve të OFK-së.
2. Vendimi i Komisionit hyn në fuqi pas kalimit të afatit të ankesës.
3. Farmacisti i fshirë nga regjistri i anëtarësisë njëherë, me rastin e riaplikimit për anëtarësim paguan taksë shtesë sipas shumës së caktuar me vendim të kuvendit.

Neni 18

E drejta e ankesës të farmacistit të fshirë nga regjistri

1. Farmacisti i fshirë nga regjistri i anëtarësisë ka të drejtë ankese ndaj vendimit të Komisionit për Licencim në Gjyqin të Nderit brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.
2. Gjyqi i Nderit e shqyrton ankesën e tillë brenda 15 ditëve nga parashtrimi i saj.
3. Gjyqi i Nderit mund të anulojë vendimin e Këshillit Etik për heqjen nga regjistri i anëtarëve të OFK-së, nëse vërtetohet se shkaqet për të cilat është marrë ky vendim nuk ekzistojnë.

KREU IX – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Dispozita kalimtare Neni 19

Komisioni për Licencim obligohet që jo më vonë se 30 ditë nga miratimi i kësaj rregullore t'i shqyrtojë të gjitha lëndët e refuzuara nga komisioni i Kuvendit I.

Dispozitat përfundimtare Neni 20

1. Me miratimin e kësaj rregullore shfuqizohen të gjitha rregulloret e kuvendit të cilat kanë implikime në procedurat dhe kriteret për regjistrimin e anëtarëve në OFK.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së saj.

Prishtinë 29/06/2019

Kryesuesi i Kuvendit të OFK-së
Dr.sc. Arianit Jakupi





ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 138 Dt 30/12/20

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 20, paragrafit 1 dhe 21 të Statutit të OFK-së, në mbledhjen e mbajtur me 26/12/2020, miraton këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORËS nr. 38 të datës 08.08.2019

- I. Pas nenit 5 të Rregullorës shtohet nen i ri me përmbajtjen
“ Neni 5 A
Anëtarët nderi të OFK-së
 1. Të gjithë anëtarët e OFK-së që arrijnë moshën 65 vjecare në shenjë mirënjohje përfitojnë statusin e anëtarit të nderit për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik të OFK-së
 2. Personat me kontribut të vecantë në sektorin farmaceutik me propozimin e Këshillit Drejtues dhe miratimin e Kuvendit të OFK-së fitojnë statusin mirënjohës të anëtarit të nderit për merita të vecanta në sektorin farmaceutik të Kosovës
 3. Anëtarët e nderit për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik janë të liruara nga të gjitha pagesat e taksave administrative për shërbimet e OFK-së.
 4. Statusi i anëtarit të nderit për merita të vecanta në sektorin farmaceutik të Kosovës nuk krijon të drejta dhe obligime në raporte të ndërsjellta me OFK-në.
 5. OFK me përmbushjen e kritereve të parapara nga paragrafi I dhe II I këtij neni, lëshon certifikatë mbi statusin e anëtarit.
- II. Autorizohet shërbimi profesional i OFK-së për spastrimin e tekstit të rregullorës 38 në përputhje me këtë vendim.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen dispozitat e rregullorës nr. 38 të datës 08.08.2019 që janë në kundërshtim me këtë vendim
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

I'dërgohet:

- Komisionit për Licencim
- Shërbimit Profesional

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi

